



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 03-03/1220/18
 Br. Prot. 03
 Prot No. 20.04.2018
 Data
 Datum
 Date
 Nr. pages 03
 PRISHTINË

DATE/A:	20.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1217/18
PËR/ZA/TO:	z. Dejan TODORVIČ, Shef i Zyrës së Prokurimit – Komuna e Graçanicës
CC:	z. Srdjan POPOVIČ, Kryetar i Komunës së Graçanicës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Shërbimet hoteliere për nevojat e Komunës së Graçanicës "

I nderuari z. TODORVIČ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Shërbimet hoteliere për nevojat e Komunës së Graçanicës** ", me numër të prokurimit: **GRA-618-18-2501-236 dhe me nr. të brendshëm: GRA-618-18-019-236**, Agjencia Kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Shërbimet hoteliere për nevojat e Komunës së Graçanicës** ", me numër të prokurimit: **GRA-618-18-2501-236 dhe me nr. të brendshëm: GRA-618-18-019-236**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 20.04.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1217/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Shërbimet hoteliere për nevojat e Komunës së Graçanicës**", me numër të prokurimit: *GRA-618-18-2501-236 dhe me nr. të brendshëm: GRA-618-18-019-236*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Graçanicës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të kuotimit të çmimeve kontratë publike të llojit shërbime, me vlerë të mesme prej 9.900,00 €. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit ka vërejtur se tek pjesa e specifikimeve teknike tek rubrika **vërejtje Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatori Ekonomik të jetë jo më largë se pesë (5) km nga objekti i Komunës. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 7.**

Agjencia, konsideron se me formulimin e kësaj kërkesë Autoriteti kontraktues ka bërë diskriminim territorial në kundërshtim me nenin 7 paragrafët 1,2,3 dhe 4 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik ku në paragrafin 1 në mënyrë decisive thuhet se "Autoriteti Kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Paragrafi 2 parasheh se "Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik".

Paragrafi 3 "pa e cenuar paragrafin e mësipërm, Autoritetit Kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose Specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik".

Në paragrafin 4 parashihet se Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik ". Me formulimin e kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktues diskriminon Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 5 km dhe në të njëjtën kohë mund të krijoj kushte favorizuese për Operatorët Ekonomik që janë brenda perimetrit prej 5 km.

Autoriteti Kontraktues në zbatim të nenit 7 të këtij Ligji, duhet të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të Operatorëve Ekonomik të interesuar. Për më tepër Autoriteti Kontraktues duhet të i'u jap mundësinë Operatorëve Ekonomik që janë jashtë perimetrit 5 km që të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi, qiramarrje me pikat e Operatorëve Ekonomik që ofrojnë shërbime që ndodhen në hapësirën e kërkuar dhe në të njëjtën kohë i mundëson Autoritetit Kontraktues të mos krijoj shpenzime të larta me rastin e këtyre shërbimeve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi dhe nenin 27 Dosja e Tenderit Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

